



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

**FJALA E KREUT TË PREZENCËS, AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH,
NË TRYEZËN E RRUMBULLAKËT TË “FORUMIT CIVIL 2010”**

29 qershor 2012

President Moisiu,
President Meidani,
Zonja dhe zotërinj,
Mirëdita!

“Forumi Civil 2010” kontribuon gjerësisht në diskutimin publik, në atë që do ta cilësoja si segmenti i cilësisë së lartë. Ju dëgjova me kujdes dhe mendoj se zëri juaj dëgjohej, por, sigurisht, nuk do të ndodhin mrekulli, ashtu sikurse kemi mësuar gjatë këtyre 20 vjetëve. Megjithatë, lejomëni të përshëndes “Forumin Civil 2010”, nën drejtimin e aftë të Presidentit Moisiu, për këtë nismë për shkëmbimin e ideve në lidhje me tema kaq të rëndësishme si reforma zgjedhore.

Të gjithë të pranishmit rreth kësaj tryeze, të paktën kjo është bindja ime e thellë, ndajnë pikëpamjen që zgjedhjet e lira dhe të ndershme, dhe lejomëni të përsëris “dhe të ndershme”, janë guri i themelit i jetës politike në një vend demokratik.

Zgjedhjet e lira dhe të ndershme përbëjnë një çast përcaktues në progresin drejt një shoqërie të vërtetë demokratike.

Kuvendi i Shqipërisë ka dhënë kontribute madhore në drejtim të reformës.

Së bashku me stafin tim, i përshëndesim këto përpjekje dhe ju sigurojmë se Prezenca e OSBE-së dhe OSBE/ODIHR-i do të vazhdojnë të mbështesin këtë proces kurdo që të jetë e mundur.

Fatkeqësisht, në periudhën e fundit kemi qenë dëshmitarë të një ngadalësimi të dukshëm të ecurisë së reformës.

Shfrytëzoj rastin të nxis Kuvendin të gjejë një përfundim të shpejtë të reformës zgjedhore. Koha po mbaron.

Të gjitha kampet politike duhet të angazhohen në mënyrë konstruktive, për të gjetur dhe zbatuar zgjidhje të qëndrueshme.

Reforma duhet të ketë konsensusin politik më të gjerë të mundur. Kjo është e nevojshme që marrëveshjet të jenë të qëndrueshme dhe t'i rezistojnë kohës.

Lejomëni të shtoj që nuk duhet që pas çdo palë zgjedhjesh të jetë prirja për të ndryshuar sërish rregullat. Kjo nuk është e dobishme, nuk është e arsyeshme dhe nuk është e drejtë për njerëzit. Rregullat e qëndrueshme do t'u shërbenin interesave të shqiptarëve dhe aspiratave të tyre evropiane më së miri.

Në veçanti, do të nxisja drejtuesit politikë që të arrijnë sa më shpejt një marrëveshje për çështjet kryesore të mbetura pezull: administrimin e zgjedhjeve, ankesat pas-zgjedhore, përmirësimin e procedurave të identifikimit të zgjedhësve dhe të procedurave të numërimit.

Përfundimi në kohë i reformës është gjithashtu i rëndësishëm për të kryer të gjitha përgatitjet administrative për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Rekomandimet e OSBE/ODIHR-it duhen zbatuar plotësisht, për të treguar vullnetin politik ende të dëshiruar.

Kur shohim Raportet përfundimtare të OSBE/ODIHR-it për vitin 2009 dhe 2011, gjejmë rreth 31 rekomandime.

Do të doja të tërhiqja vëmendjen tuaj vetëm te njëri prej tyre. E citova më parë dhe ju e keni dëgjuar edhe herë të tjera. Por udhëheqësit politikë dhe ata që dëshirojnë të bëhen udhëheqës politikë duhet t'i kenë parasysh dhe t'i vënë në jetë. Jo më kot ky është dhe rekomandimi i parë, që lidhet me atë çfarë duhet të bëjnë partitë politike.

Po citoj: "*Partitë politike duhet të tregojnë vullnet politik për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike që u korrespondon privilegjeve të mëdha që gëzojnë sipas ligjit në lidhje me zhvillimin e zgjedhjeve. Ato duhet të përmbushin detyrat e tyre zgjedhore në mënyrë të përgjegjshme në interesin e përgjithshëm të Shqipërisë*". Fundi i citimit.

Mendoj se kjo është një gjuhë e qartë.

Megjithatë, marrja e këtyre përgjegjësi për interesin e përgjithshëm të Shqipërisë dhe në të mirë të publikut dhe vendosja e tyre mbi interesat miope vetjake mbetet ende për t'u parë.

President Moisiu,
President Meidani,
Zonja dhe zotërinj,

Qytetarët shqiptarë meritojnë zgjedhje të mira, zgjedhje të lira e të ndershme. Zgjedhje plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare.

I nxis të gjitha partitë politike të ecin përpara dhe të nxjerrin një produkt të suksesshëm për qytetarët e këtij vendi, të bazuar në dialog, bashkëpunim dhe respekt.

Më pas, ata duhet ta nderojnë dhe ta zbatojnë plotësisht këtë produkt.

Po ashtu, do të doja t'u bëja thirrje aktorëve të shoqërisë civile të *veprojnë tani* dhe të luajnë rolin e tyre për të ushtruar presion mbi partitë politike të cilat nuk lëvizin ndryshe. Ato duhet të lëvizin.

Kjo do të mundësonte që çdo reformë e Kodit Zgjedhor për të cilën është rënë dakord, të jetë në përputhje me interesat civilë dhe jo vetëm me ato të partive politike.

Më lejoni të mbyll fjalën duke theksuar se e gjithë OSBE-ja e mbështet fort këtë çështje në ndihmesën që i jep procesit.

Megjithatë, është e qartë se përgjegjësia përfundimtare për një përfundim të suksesshëm të reformës zgjedhore dhe të zgjedhjeve sipas standardeve ndërkombëtare, i takon Shqipërisë, si një vend sovran.

Dhe këtij formati, juve, “Forumit Civil 2010” dua t’ju them thjesht: vazhdoni me punën e mirë të nisur. Është shumë e nevojshme.

Faleminderit shumë!

KOMENTET E AMBASADORIT NË MBYLLJE TË TRYEZËS

Ambasadori Wollfarth: “Do të doja të komentoja sa i përket çështjes nëse ne duhet të jemi më shumë të pranishëm gjatë një procesi që duhet të jetë sovran, në një vend sovran, që e përmenda edhe në fjalën time. Në kontekstin e reformës së Kodit Zgjedhor ose të reformës zgjedhore, teknika e përdorur nga OSBE/ODIHR-i është të ofrojë këshillë në bazë të rezultateve të vëzhgimit gjatë zgjedhjeve dhe, më pas, në bazë të përfundimeve dhe rekomandimeve. Është një këshillë, rekomandim, apo një sërë rekomandimesh, në bazë të vëzhgimeve dhe situatës ligjore, që tregon sesi është zbatuar ligji.

E rëndësishme në një vend sovran është që kjo të bëhet nga përfaqësuesit e tij, duke përfshirë edhe diskutimet publike, të cilat janë të përshtatshme, të pavarura, në kohën e duhur dhe të plota.

Nuk janë të huajt që duhet të drejtojnë një vend të pavarur, janë qytetarët e këtij vendi që e drejtojnë këtë vend.

Askush nga ODIHR-i nuk do të vijë këtu për të dhënë udhëzime apo për të imponuar zgjidhje. Kjo është thjesht një ofertë. Ai që vendos është parlamenti. Ata janë të vetmit që kanë të drejtën të formulojnë ligje dhe t’i miratojnë ato. Grupi i njerëzve që kanë këtë të drejtë, në këtë fazë, brenda parlamentit, janë anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore. Por, edhe jashtë parlamentit, është e rëndësishme që kjo të ndiqet nga partitë politike, nga drejtuesit e tyre, nga shoqëria civile dhe nga media, në mënyrë që të ketë diskutim dhe presion për të ecur përpara, për të pasur drafte të mira dhe një përfundim të mirë.

Ky proces shoqërohet nga OSBE/ODIHR-i, por ndryshimi vendimtar qëndron në faktin që shoqërohet, nuk drejtohet nga OSBE/ODIHR-i. Ky është një ndryshim shumë i rëndësishëm: duhet të jetë gjithmonë një proces shqiptar, i drejtuar nga shqiptarët. Dua t’ju kujtoj që Shqipëria është një vend sovran që duhet respektuar, por kjo sjell dhe përgjegjësi.

Fajësimi i atyre që janë jashtë Shqipërisë për diçka që duhet të vendoset këtu, nuk është mënyra e duhur. Është mënyra e gabuar, jo e drejtë dhe një shfajësim i papranueshëm për mosveprimin.

Ndihma që vjen nga OSBE/ODIHR-i dhe nga institucione të tjera si, Këshilli i Evropës, është aty: ajo është një këshillë, jo një urdhër. Është një ofertë për këshillë që duhet respektuar dhe zbatuar këtu. Dhe nëse ky zbatim nuk ndodh, fajësoni shqiptarët, mos fajësoni ndërkombëtarët”.